

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve: F. D. dhe G. D. që të dy nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP.nr.371/2012 të datës 24.05.2013, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurorit të Shtetit Sahide Sefa dhe të akuzuarve, me datë 03.04.2015, publikisht morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### Të akuzuarit:

**F. D.** nga i ati H. dhe e ëma H.1 e lindur K., i lindur më datë “data e lindjes.. “ në fshatin ..... Komuna e Suharekës, tani me banim në Prizren rruga “.... . .” nr. .. , ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i martuar baba i pesë fëmijëve, me numër personal ....., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

**G. D.** nga i ati H. dhe e ëma H.1 e lindur K., i lindur më datë “data e lindjes..” në fshatin ..... Komuna e Suharekës tani me banim në Prizren rruga “.... . .” nr. .. , ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i martuar baba i dy fëmijëve, me numër personal ....., ashkali, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

### JANË FAJTOR

Me datë 26.11.2012 rreth orës 19:00, në Prizren rrugën “..... ....” të akuzuarit duke e përdorë mjet të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, i shkaktojnë lëndim trupor të dëmtuarit i cili rezultoi me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kanë pasur me të akuzuarit F. S. dhe B. S. lidhur me atë se vëllain e tyre A. e kanë futur me forcë në automjet, i akuzuari F. D. së bashku me atë akuzuarit A. D. dhe J. D. e sulmojnë fizikisht me grushte nëpër pjesë të ndryshme të trupit të dëmtuarin Xh. M., i akuzuari G. M. e godet të dëmtuarin me një shufër metalike në kokë, duke i shkaktuar lëndime në formë të ndryshme të muskujve të kokës dhe plagë shqyese në regjionin e tepes së kokës të cilat kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor.

**Këso dore në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 153 par.2 lidhur me par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK, të akuzuarve iu shqipton:

### DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit **F. D.** vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit **G. D.** vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprën të re penale.

I dëmtuari Xh. (C.) M. nga Prizreni rruga “.....” nr. . , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohen të akuzuarit në mënyrë solidare të paguajnë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 20.44 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajë shumen prej nga 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP.nr.371/2012 të datës 24.05.2013 kundër të akuzuarve: F. D. dhe G. D. që të dy nga Prizreni, për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK.

Prokurori Shtetit Sahide Sefa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ngel në tërësi pranë aktakuzës së parashtruar nga ana e prokurorisë nën numrin PP.nr.371/2012 të datës 24.05.2013, parashtruar kundër të akuzuarve F. D. dhe G. D. , për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nën par.1 lidhur me nenin 23 të KPK, pasi që në shqyrtimin gjyqësor të akuzuarit vullnetarisht kanë pranuar fajësinë e cila është në pajtim me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, me ç’rast edhe është vërtetuara në tërësi gjendja faktike siç është e përshkruar në aktakuzë, andaj propozon gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohen dhe të dënohen sipas ligjit.

I akuzuarit F. D. në fjalën përfundimtare deklaron se ditën kritike ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet, por me arsyetim se është irrituar nga veprimet e dëmtuarit Xh. M. , pasi që ai kishte rrëmbyer vëllain e tij A. . I akuzuari thekson se i ka rregulluar raportet me familjen e dëmtuarit dhe nuk kanë kurrfarë problemi, andaj propozon gjykatës që të ketë parasysh të gjitha këto rrethana dhe ndaj tij të shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari G. D. në fjalën përfundimtare deklaron se i bashkëngjitet fjalëve të vëllait të tij dhe e lutë gjykatën që të shqiptoj një dënim sa më të butë pasi që është mbajtës i vetëm i familjes dhe mjetet financiare e siguron nga puna e tij si punëtor i ndërtimitarisë të cilën e ushtron kohë pas kohe – në sezonë.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 26.11.2012 rreth orës 19:00, në Prizren rrugën “..... ....” të akuzuarit F. D. dhe G. D. bashkërisht me të akuzuarit A. D. dhe J. D. , i shkaktojnë lëndime trupore të dëmtuarit Xh. M. nga Prizreni, në atë mënyrë që si rezultat i mosmarrëveshjeve paraprake rreth një problemi lidhur me vëllain e tyre A. , të njëjtit e sulmojnë me grushte nëpër pjesë të ndryshme të trupit të dëmtuarin. Ndërsa i akuzuari G. D. në situatën e tensionuar e

përdorë mjet të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, ashtu që e godet të dëmtuarin me një shufër metalike në kokë dhe i shkaktuar lëndime në formë të ndrydhjes së muskujve të kokës dhe plagë shqyese në regjionin e tepes së kokës të cilat kanë karakter të lëndimit të lehtë trupor.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar në shqyrtimin kryesor ku të akuzuarit vullnetarisht kanë pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Mirëpo gjykata sipas detyrës zyrtare nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e cila mbështet në fakte dhe prova materiale që janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me kohë. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nën par.1 të KPK dhe për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarve, rrethanat familjare të tyre, të akuzuarit janë kryefamiljar, që do të thotë se janë mbajtës i familjeve të tyre, andaj gjykata iu shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj iu shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryejnë veprë të re penale, duke menduar se dënimet e shqiptuara i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.159/2013 të datës 03.04.2015**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate